



# **PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 - 2030**

**Përgatitur nga Bashkia Durrës  
në kuadër të zbatimit të  
Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030  
si dhe  
Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore**

**11** Maj, 2026

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026 – 2030 u përgatit nga Bashkia Durrës me mbështetjen e UN Women Shqipëri në kuadër të zbatimit të projektit: “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri” (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

Ky plan u hartua nga Komisioni i Barazisë Gjinore (KBGJ) në Bashkinë Durrës, i përbërë nga:

1. Egert Hoxha, Nënkryetar i Bashkisë, Kryetar i KBGJ në nivel bashkie
2. Diola Xhango, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Anëtare
3. Valbona Qiriako, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit, Anëtare
4. Ina Ferra, Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, Anëtare
5. Migena Muhja, Drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Sportit, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare, Anëtare
6. Ana Hoxha, Drejtore e Drejtorisë së Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Anëtare
7. Alda Zyferi, Drejtore e Drejtorisë së Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Anëtare
8. Ornela Hamataj, Drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, Anëtare
9. Andi Cërri, Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Civile, Anëtar
10. Rudina Trikshiqi, Përgjegjëse e Sektorit të Mjedisit dhe Energjisë, Anëtare
11. Anisa Allka, Nëpunëse e Barazisë Gjinore, Anëtare

Ekspertiza teknike nga UN Women:

1. Monika Kocaqi, Konsulente për integrimin gjinor dhe vetëqeverisjen vendore
2. Diamanta Vito, Konsulente për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe vetëqeverisjen vendore

© Bashkia Durrës, 2026. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Sqarim:

Ky dokument përmban mendimet dhe pikëpamjet e shprehura nga autoret dhe autorët dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo organizmave të saj.

## *Fjala e Kryetares*

*Barazia gjinore përbën jo vetëm një të drejtë themelore të njeriut, por edhe një shtyllë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe konkurrues në nivel vendor. Bashkia Durrës mbetet e angazhuar të ndërtojë një qytet ku gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë, për të kontribuar dhe për të përfituar nga zhvillimi ekonomik, social dhe kulturor i territorit.*

*Si një nga bashkitë më të rëndësishme në vend, me një rol kyç në ekonominë kombëtare përmes portit, turizmit, shërbimeve dhe zhvillimit urban, Durrësi përballet njëkohësisht me sfida të lidhura me transformimet ekonomike, migracionin, punësimin dhe përfshirjen sociale. Në këtë kontekst, integrimi gjinor në politikat vendore është thelbësor për të siguruar që zhvillimi të jetë i drejtë dhe i aksesueshëm për të gjitha/gjithë.*

*Gratë dhe të rejtat në Bashkinë Durrës përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social, por vijojnë të përballen me pengesa strukturore në aksesin në tregun e punës, në burimet ekonomike dhe në proceset vendimmarrëse. Për këtë arsye, fuqizimi i tyre mbetet një prioritet strategjik i bashkisë.*

*Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030 ndërtohet mbi përvojën e mëparshme të bashkisë dhe mbi analizën e gjetjeve të raportit të monitorimit të periudhës 2023–2025, duke reflektuar arritjet e konsoliduara, por edhe nevojën për të avancuar më tej drejt një qasjeje të orientuar në rezultate të matshme dhe ndikim të qëndrueshëm. Ky plan përfaqëson një instrument të rëndësishëm për orientimin e politikave vendore dhe për forcimin e rolit të bashkisë në promovimin e barazisë gjinore.*

*Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Durrës synon të thellojë ndërhyrjet për fuqizimin ekonomik të grave dhe të rejave, të rrisë aksesin në mundësi punësimi dhe sipërmarrjeje, të mbështesë zhvillimin e shërbimeve të kujdesit që lehtësojnë balancën punë–familje, si dhe të forcojë pjesëmarrjen e grave në jetën publike dhe vendimmarrjeje. Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu forcimit të mekanizmave për parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave e dhunës në familje, si dhe përmirësimit të sigurisë dhe mirëqenies në komunitet.*

*Një dimension i rëndësishëm i këtij plani është përfshirja aktive e të rejave dhe të rinjve, si dhe adresimi i nevojave të grupeve në situatë të cënueshme, përfshirë komunitetet rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë në zonat rurale, duke synuar reduktimin e barrierave që kufizojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetën ekonomike dhe sociale.*

*Ky plan përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të një qeverisjeje vendore më të ndjeshme gjinore, më transparente dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve dhe qytetarëve. Ai synon të sigurojë që barazia gjinore të mos trajtohet si një fushë e veçantë, por si një dimension i integruar në të gjitha politikat dhe shërbimet e bashkisë. Në këtë kuadër, Bashkia Durrës shpreh mirënjohjen e saj për mbështetjen teknike dhe financiare të UN Women dhe Bashkimit Evropian, që kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve vendore dhe në avancimin e politikave për barazi gjinore.*

Znj. Emiriana Sako  
Kryetare  
Bashkia Durrës

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE.....</b>	<b>5</b>
<b>I. HYRJE.....</b>	<b>6</b>
<b>II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL.....</b>	<b>9</b>
<b>III. GJETJET NGA MONITORIMI I ZBATIMIT TË PVVBGJ 2023–2025.....</b>	<b>12</b>
<b>IV. METODOLOGJIA.....</b>	<b>14</b>
<b>V. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHRYJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË.....</b>	<b>16</b>
<b>VII. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2026 - 2030.....</b>	<b>20</b>
<b>VII. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....</b>	<b>22</b>
<b>VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2030.....</b>	<b>23</b>

DRRAFET

## LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
DHnGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinor (për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)
KB	Këshilli Bashkiak
KBRE	Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës
LGBTI+	Persona lezbike, gej, biseksuale/ë, transgjinore/ë, transseksuale/ë, interseks dhe cilëdo persona të tjerë orientimi seksual dhe/ose shprehja e identitetit gjinor të të cilave/ëve është i ndryshëm nga heteroseksualet/ët.
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi Administrative
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jo-Fitim-Prurëse
ON	Organizatë Ndërkombëtare
OS	Objektiv Specifik
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PVVBGJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030)
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

## I. HYRJE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026–2030 për Bashkinë Durrës përfaqëson instrumentin kryesor strategjik për promovimin e barazisë gjinore dhe për integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha politikat, programet dhe shërbimet vendore. Ky plan, i treti i kësaj natyre, është hartuar në kuadër të angazhimeve të bashkisë për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të cilën Bashkia Durrës e ka nënshkruar që në mars 2017, duke ndërmarrë një angazhim të qartë publik për avancimin e barazisë gjinore në nivel vendor.

PVVBGJ 2026–2030 është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe ndërveprues, i zhvilluar në bashkëpunim me strukturat e bashkisë, institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë vendorë. Procesi është mbështetur nga UN Women në Shqipëri, në kuadër të zbatimit të projektit: “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri” (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

Durrësi, si një nga qytetet më të rëndësishme në Shqipëri, me një histori të pasur kulturore dhe një rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit, përfaqëson një territor me potencial të lartë për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Në të njëjtën kohë, për shkak të karakteristikave si qendër portuale, turistike dhe urbane në transformim, bashkia përballlet me sfida të lidhura me punësimin, migracionin, zhvillimin urban dhe përfshirjen sociale.

Në këtë kontekst, barazia gjinore nuk përbën vetëm një objektiv social, por një parakusht për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe për përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjitha/gjithë qytetaret dhe qytetarët. Gratë dhe të rejtat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të potencialit zhvillimor të bashkisë, megjithatë, ato vijnë të përballen me kufizime në aksesin në tregun e punës, në burimet ekonomike dhe në proceset vendimmarrëse, veçanërisht kur këto ndërthuren me faktorë të tjerë të cenueshmërisë.

Ky plan ndërtohet mbi përvojën e mëparshme të Bashkisë Durrës në hartimin dhe zbatimin e politikave për barazinë gjinore. Bashkia ka qenë ndër të parat në vend që ka ngritur struktura të dedikuara për barazinë gjinore dhe mekanizma për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, duke krijuar një bazë të rëndësishme institucionale për zhvillimin e mëtejshëm të politikave në këtë fushë.

Hartimi i PVVBGJ 2026–2030 mbështetet gjithashtu në analizën e zbatimit të planit të mëparshëm dhe në gjetjet e raportit të monitorimit për periudhën 2023–2025, i cili evidenton progres të rëndësishëm në drejtim të institucionalizimit të politikave gjinore dhe zbatimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe sociale, por njëkohësisht nënvizon nevojën për forcimin e mekanizmave të monitorimit, përmirësimin e mbledhjes së të dhënave gjinore dhe orientimin më të qartë drejt rezultateve dhe ndikimit.

Në këtë kuadër, PVVBGJ 2026–2030 synon të adresojë në mënyrë më të strukturuar dhe të integruar sfidat e identifikuara, duke forcuar lidhjen ndërmjet planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe buxhetimit të politikave vendore. Plani promovon një qasje të integruar që lidh fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave, përmirësimin e shërbimeve sociale dhe të kujdesit, rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje, si dhe forcimin e mekanizmave për parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore.

**Barazia gjinore** nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lira/lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

**Drejtësia gjinore** nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).<sup>1</sup>

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi<sup>2</sup>, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të përparojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave<sup>3</sup>, të rejave dhe të rinjve<sup>4</sup>, vajzave dhe djemve.<sup>5</sup> Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

Barazia gjinore, në këtë plan, kuptohet si një proces që kërkon jo vetëm trajtim të barabartë, por edhe masa specifike për të adresuar pabarazitë ekzistuese dhe disavantazhet historike dhe sociale. Në këtë kuptim, koncepti i drejtësisë gjinore merr një rol qendror, duke synuar sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë, në përputhje me nevojat dhe realitetet e ndryshme të grave dhe burrave.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore.

Në këtë kuadër, PVVBGJ 2026–2030 synon të kontribuojë në ndërtimin e një modeli të qeverisjes vendore që është më i ndjeshëm gjinor, më gjithëpërfshirës dhe më i orientuar drejt rezultateve, duke vendosur barazinë gjinore në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkisë Durrës.

<sup>1</sup> Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

<sup>2</sup> Shih: [https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter\\_2022\\_EN.pdf](https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter_2022_EN.pdf)

<sup>3</sup> "Gra dhe burra" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

<sup>4</sup> "Të reja dhe të rinj" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 15 - 29 vjeç, në respektim edhe të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar.

<sup>5</sup> "Vajza dhe djem" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç, në përputhje me Ligjin Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" (neni 3, pika 4).

Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja **“në të gjithë diversitetin e tyre”**, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj. pra nga të gjithë grupet në shoqëri. Ky term gjithashtu përdoret gjerësisht në dokumentet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që janë pjesë e acquis të BE-së për barazinë gjinore, ku specifikisht adresojmë Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2026-2030<sup>6</sup>, si dhe Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III 2021 – 2025/2027<sup>7</sup> (EU GAP III).

Theksi te gratë, të rejat dhe vajzat, nga të gjitha qupet në shoqëri, është vënë edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, dokumenti kryesor i politikave në nivel kombëtar që përshkruan veprimet që duhet të ndërmerren për përparimin drejt barazisë gjinore.

**Prandaj, kudo në këtë tekst, togfjalëshi “në të gjithë diversitetin e tyre” nënkupton që veprimet dhe masat e ndërmarra synojnë të përfshijnë gra, të reja, vajza në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj.**

<sup>6</sup> Shih: [https://commission.europa.eu/document/1f5fa936-9fba-4435-93f5-32fa220bac82\\_en](https://commission.europa.eu/document/1f5fa936-9fba-4435-93f5-32fa220bac82_en)

<sup>7</sup> EU GAP III u përgatit fillimisht për periudhën kohore 2021 – 2025, por në nëntor të vitit 2023, BE vendosi të shtrijë kohëzgjatjen e tij deri në vitin 2027. Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/news/gender-equality-eu-extends-duration-gender-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21\\_en](https://enlargement.ec.europa.eu/news/gender-equality-eu-extends-duration-gender-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21_en) Ndërkohë që kanë filluar përgatitjet e EU GAP IV 2028-2034. Shih: [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_26\\_526](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_26_526)

## II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Në nenin 18 të Kushtetutës qartësohet shprehimisht se: “1. Të gjitha/gjithë janë të barabarta/barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.

Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentesh ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2030 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

### a) *Instrumente ndërkombëtarë*

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore (EU Charter for Equality).<sup>8</sup>
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjenda 2030.
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2026-2030 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (EU GAP III) 2021-2027, etj.

Ky kuadër ndërkombëtar ofron bazën normative për hartimin dhe zbatimin e politikave për barazinë gjinore në nivel vendor, duke orientuar ndërhyrjet drejt parandalimit të dhunës ndaj grave e dhunës në familje, fuqizimit ekonomik të grave dhe garantimit të pjesëmarrjes së tyre të barabartë në jetën publike. Për Bashkinë Durrës, këto instrumente përbëjnë një referencë të rëndësishme për përshtatjen e politikave vendore me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

---

<sup>8</sup> E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

## **b) Kuadri ligjor kombëtar<sup>9</sup>**

- Ligji Nr.64/2025, datë 06.11.2025 “Për barazinë gjinore”.<sup>10</sup>
- Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligji Nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”.<sup>11</sup>
- Ligji Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i procedurës penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”.
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar etj.

## **c) Politikat kombëtare**

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2026 - 2030 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030**.<sup>12</sup> Është e rëndësishme të theksohet që në fillim të këtij viti u përgatit dhe një raport i vlerësimit të zbatimit të SKBGJ 2021-2030 për pesë vitet e para (2021-2025) dhe mbi bazën e këtij raporti dhe kuadrit ligjor të përmirësuar, po bëhet dhe rishikimi i Planit të Veprimit të SKBGJ për periudhën 2026-2030.

Në përgatitjen e PVVBGJ Bashkia Durrës ka marrë në konsideratë edhe komunikimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë procesit të vlerësimit të SKBGJ,

<sup>9</sup> Theksojmë se kjo listë nuk është shteruese. Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ, mbështeten jo vetëm në këtë kuadër ligjor për barazinë gjinore, por edhe në ligje të veçanta në përputhje me fushën përkatëse të ndërhyrjes.

<sup>10</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr.229 në dhjetor 2025. Shih: [https://qbz.gov.al/alfresco/api/-default-public/alfresco/versions/1/nodes/b69d770a-44f9-4a06-990c-](https://qbz.gov.al/alfresco/api/-default-public/alfresco/versions/1/nodes/b69d770a-44f9-4a06-990c-64b22c7f1d09/content?attachment=false&alf_ticket=TICKET_baacf20eab6c6e0757a71d34fe6dba484f13089e)

[64b22c7f1d09/content?attachment=false&alf\\_ticket=TICKET\\_baacf20eab6c6e0757a71d34fe6dba484f13089e](https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/Ligji-nr.11-2026-Per-parandalimin-dhe-mbrojtjen-nga-dhuna-ndaj-grave-dhe-dhuna-ne-familje.pdf)  
<sup>11</sup> Shih: <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/Ligji-nr.11-2026-Per-parandalimin-dhe-mbrojtjen-nga-dhuna-ndaj-grave-dhe-dhuna-ne-familje.pdf>

<sup>12</sup> Miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

sidomos në lidhje me drejtimet prioritare për vitet në vijim. Në këtë kuadër, Bashkia Durrës ka reflektuar në PVVBGJ 2026–2030 gjetjet dhe sfidat e identifikuar në nivel vendor, duke i lidhur ato me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, veçanërisht në drejtim të forcimit të mekanizmave institucionalë, parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe nevojës për rritjen e ndërhyrjeve në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave.

#### **d) Institucionet përgjegjëse**

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjëse/përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. **Megjithatë, ky Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, nuk është plani i një nëpunëseje/nëpunësi të vetëm**, por përfaqëson një përgjegjësi të përbashkët të të gjithë strukturave të bashkisë dhe aktorëve vendorë, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe **Aleanca e Grave Këshilltare** dhe **Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit** në nivel të Këshillit Bashkiak<sup>13</sup>, i përbërë nga 5 anëtare/anëtarë, 2 gra dhe 3 burra.

Për të garantuar zbatimin efektiv dhe monitorimin e vazhdueshëm të PVVBGJ, Bashkia Durrës gjatë zbatimit të PVVBGJ 2023-2025 ka ngritur dhe funksionalizuar një **Komision për Barazinë Gjinore / Grup Monitorimi** në nivel bashkie, i përbërë nga përfaqësuese e përfaqësues të drejtorive kryesore përgjegjëse. Ky mekanizëm edhe gjatë zbatimit të PVVBGJ 2026-2030 do të luajë një rol kyç në koordinimin ndërinstitutional, ndjekjen e progresit dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe dokumentet zhvillimore të bashkisë.

Ky Komision/Grup, do të mundësojë një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për përparimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre dhe arritjen e barazisë gjinore.

Në vijim, bashkëpunimi me institucionet vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë mbetet thelbësor për zbatimin efektiv të masave të parashikuara në këtë PVVBGJ dhe për arritjen e rezultateve të qëndrueshme në drejtim të barazisë gjinore.

---

<sup>13</sup> Shih: <https://durrës.gov.al/perberja-e-komisioneve/>

### III. GJETJET NGA MONITORIMI I ZBATIMIT TË PVVBGJ 2023–2025

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2023–2025 për Bashkinë Durrës ofron një bazë të rëndësishme evidencash për të vlerësuar progresin e arritur, për të identifikuar sfidat dhe për të orientuar drejtimet prioritare të fazës së ardhshme të planifikimit. Analiza mbështetet në të dhënat e raportimit institucional, dokumentet e planifikimit dhe buxhetimit vendor, si dhe në informacionin e mbledhur nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e planit.

Në aspektin e zbatimit operacional, analiza tregon se një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar plotësisht ose pjesërisht gjatë periudhës së monitorimit. Në këtë kuadër, një nga komponentët me nivelin më të lartë të realizimit lidhet me aktivitetet ndërgjegjësuere dhe komunitare, ndërsa aktivitetet që lidhen me zhvillimin e instrumenteve metodologjike, sistemet e të dhënave dhe mekanizmat institucionalë kanë avancuar në mënyrë më të kufizuar.

Gjetjet e monitorimit tregojnë gjithashtu se Bashkia Durrës ka bërë progres të rëndësishëm në drejtim të institucionalizimit të politikave vendore për barazinë gjinore. Ky progres reflektohet në forcimin gradual të strukturave përgjegjëse, në përfshirjen më të gjerë të drejtorive në zbatimin e aktiviteteve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit institucional për rëndësinë e integritit të perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet vendore.

Një nga aspektet më të konsoliduara të zbatimit të planit lidhet me aktivitetet ndërgjegjësuere dhe komunitare, të cilat kanë shënuar një nivel të lartë realizimi. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi barazinë gjinore, në promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave, si dhe në forcimin e bashkëpunimit me aktorët vendorë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore. Këto ndërhyrje përfaqësojnë ndër komponentët me shkallën më të lartë të realizimit në kuadër të planit, duke reflektuar edhe një angazhim të qëndrueshëm institucional dhe bashkëpunim aktiv me aktorët vendorë.

Po ashtu, evidentohet progres në ndërhyrjet që lidhen me fuqizimin ekonomik të grave dhe të rejave, përmes mbështetjes së iniciativave për punësim, aftësim dhe sipërmarrje, si dhe në përmirësimin e shërbimeve sociale, veçanërisht atyre që lidhen me kujdesin për fëmijët dhe mbështetjen e familjeve. Këto ndërhyrje kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën ekonomike dhe në lehtësimin e balancës ndërmjet jetës profesionale dhe asaj familjare.

Megjithatë, analiza tregon se progresi nuk ka qenë i njëtrajtshëm në të gjitha fushat e ndërhyrjes. Aktivitetet që kërkojnë zhvillim të instrumenteve metodologjike, standardizim të proceseve apo institucionalizim të mekanizmave të rinj kanë avancuar me ritme më të ngadalta. Në veçanti, evidentohen boshllëqe në zhvillimin e sistemeve të mbledhjes dhe analizës së të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe në përdorimin e këtyre të dhënave për të mbështetur vendimmarrjen dhe planifikimin strategjik. Në të njëjtën kohë, këto fusha përfaqësojnë edhe ato ndërhyrje ku progresi ka qenë më i kufizuar, duke reflektuar kompleksitetin më të lartë teknik dhe nevojën për zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me sfidat në matjen e rezultateve dhe ndikimit të ndërhyrjeve. Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar plotësisht ose pjesërisht, evidentohet se monitorimi është fokusuar kryesisht në nivel aktivitetesh dhe më pak në nivel rezultatesh dhe ndryshimesh të qëndrueshme. Kjo nënvizon nevojën për një përmirësim të mëtejshëm të kornizës së treguesve dhe të sistemeve të monitorimit, në mënyrë që të mundësohet një vlerësim më i qartë i ndikimit të politikave të zbatuara.

Në aspektin financiar, raporti i monitorimit evidenton se sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe të qëndrueshme mbetet një sfidë për zbatimin e plotë të disa masave, veçanërisht atyre që kërkojnë ndërhyrje afatgjata dhe strukturore. Në këtë drejtim, del në pah nevoja për një lidhje më të fortë ndërmjet planifikimit strategjik dhe buxhetimit vendor, si dhe për integrimin më të plotë të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në proceset financiare të bashkisë.

Megjithë këto sfida, analiza tregon se Bashkia Durrës ka demonstruar fleksibilitet dhe kapacitet përshtatës në zbatimin e aktiviteteve, duke arritur të sigurojë rezultate edhe përmes formave alternative ndërhyrjeje dhe bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm vendorë. Kjo përbën një bazë të rëndësishme për ndërtimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve në periudhën 2026–2030.

Në përfundim, gjetjet e monitorimit tregojnë se Bashkia Durrës ka krijuar një bazë të konsoliduar për zhvillimin e politikave vendore për barazinë gjinore, me një nivel të mirë realizimi të aktiviteteve në disa fusha prioritare. Megjithatë, faza e ardhshme kërkon një fokus më të madh në forcimin e sistemeve të monitorimit, në përdorimin e të dhënave për vendimmarrje dhe në orientimin e ndërhyrjeve drejt rezultateve të matshme dhe ndikimit të qëndrueshëm. Këto gjetje konfirmojnë gjithashtu rëndësinë e forcimit të integritetit të perspektivës gjinore në të gjitha proceset e planifikimit dhe buxhetimit vendor, si një parakusht për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe të matshme.

#### IV. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2026 - 2030 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Ngritja e Grupit të Punës.** Grupi i Punës për hartimin e këtij PVVBGJ tashmë është Komisioni i Barazisë Gjinore në Bashkinë Durrës, ngritur me Urdhër të Kryetares, nr. 126, datë 08.04.2026 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Barazisë Gjinore në Bashkinë Durrës”, nën detyrat dhe përgjegjësisë të cilit, ndër të tjera është edhe hartimi i PVVBGJ-së. Në përbërje të këtij Komisioni janë 11 përfaqësuese dhe përfaqësues (2 burra) përkatësisht nga Kabineti i kryetares, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Arsimit-Kulturë-Sport-Rini-Komunitete Fetare, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, si dhe nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile. Pjesë e KBGJ në nivel bashkie është gjithashtu edhe Nëpunësja e Barazisë Gjinore.
- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
- **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t’u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2026-2030.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.
- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratoret/administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët, por edhe për të diskutuar mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ. Janë zhvilluar gjithsej **tre takime të Grupit të Punës**, përkatësisht në datat 8 prill, 24 prill dhe 29 prill 2026.<sup>14</sup>
- **Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh.** Grupi i Punës në takimin e dytë të tij (përkatësisht në datën 24 prill 2026) ftoi edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVVBGJ. Ky takim rezultoi mjaft efektiv dhe ndikoi në qartësimin e mëtejshëm të ideve të diskutuara paraprakisht nga grupi i punës, lidhur me masat dhe veprimet që duhet të përmbante matrica e PVVBGJ.

---

<sup>14</sup> Ky takim është planifikuar iu dedikua fillimit të punës për kostimin e masave të parashikuara në draft matricën e PVVBGJ, proces ky që do të zhvillohet paralelisht me periudhën në të cilën draft PVVBGJ do të qëndrojë e publikuar në faqen e bashkisë për konsultim publik.

- **Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2026 - 2030.** Drafti matrica e përgatitur për konsultim përmbante masat dhe veprimet e parashikuara të përfshira në katër fusha ndërhyrjeje, të bazuara edhe në fushat prioritare të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (pra fuqizimi ekonomik, pjesëmarrja në vendimmarrjen politike e publike, dhuna ndaj grave e dhuna në familje, si dhe integrimi gjinor në nivelin vendor). Në draft matricën e përgatitur janë reflektuar vazhdimisht të gjitha ndryshimet e dakortësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.
- **Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.** Ky proces do të zhvillohet nga Drejtoria e Shërbimit Social në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e angazhuara për hartimin e PVVBGJ gjatë periudhës që draft plani do të qëndrojë i publikuar në faqen e internetit për komente dhe sugjerime. Në konsultime është shumë e rëndësishme të merret edhe mendimi dhe kontributi i Aleancës së Grave Këshilltare dhe Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, në nivel të Këshillit Bashkiak. PVVBGJ 2026 – 2030 u postua në faqen e internetit të bashkisë për konsultim publik në datën maj 2026.<sup>15</sup> Të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik, do të reflektohen nga grupi i punës dhe ekspertet në versionin përfundimtar të PVVBGJ 2026-2030, që do të dorëzohet më pas për miratim në Këshillin Bashkiak.
- **Kostimi i draft PVVBGJ 2026-2030.** Procesi i kostimit të draft PVVBGJ 2026-2030 është parashikuar të zhvillohet paralelisht me procesin e konsultimit publik, duke filluar nga takimi specifik me grupin e punës, në datën 29 prill 2026. Ky proces do të finalizohet pasi të ketë përfunduar tërësisht rishikimi i matricës së PVVBGJ dhe të jenë saktësuar të gjitha masat dhe veprimet që do përmbajë ky dokument.
- **Miratimi i PVVBGJ 2026 – 2030 në Këshillin Bashkiak.** Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar do të përcillet për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2026 – 2030 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.

**Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2030 i Bashkisë Durrës, u miratua në mbledhjen e Këshillit Bashkiak në xx.xx.2026.<sup>16</sup>**

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE.<sup>17</sup>

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PVVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women, përmes dy konsulentëve<sup>18</sup> të angazhuara për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të projektit: “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri” (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

<sup>15</sup> Shih: <https://durrës.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/>

<sup>16</sup> Shih: <https://durrës.gov.al/vendime-te-keshillit-bashkiak-2/>

<sup>17</sup> Për më shumë shih: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

<sup>18</sup> Znj. Monika Kocaqi, eksperte e nivelit të lartë për integrimin gjinor dhe vetëqeverisjen vendore, si dhe znj. Diamanta Vito, eksperte e nivelit të lartë për buxhetimin e përgjigshëm gjinor dhe vetëqeverisjen vendore. Për përgatitjen e treguesve gjinorë të këtij PVVBGJ u angazhua edhe znj. Majlinda Nesturi, eksperte e nivelit të lartë për statistikat dhe treguesit gjinorë.

## V. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

**Vizioni:** *“Gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Durrësit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantëve/emigrantit e azilkërkuarëve/azilkërkuarës, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.*

**Parimet**<sup>19</sup> që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, në vendimmarrje, është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

### Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBGJ 2026 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030. Gjithashtu në formulimin e këtyre fushave të ndërhyrjes dhe objektivave specifike janë mbajtur në konsideratë edhe objektivat e parashikuara në Strategjinë e BE për Barazinë Gjinore 2026-2030, si dhe masat dhe veprimet e parashikuara në EU GAP III 2021-2027.

Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Fuqizimi ekonomik dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në tregun e punës dhe zhvillimin vendor.
- II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në jetën publike dhe vendimmarrjen në nivel vendor, në funksion të një qeverisjeje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë..
- III. Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe forcimi i sigurisë, reziliencës dhe menaxhimit gjithëpërfshirës së emergjencave në komunitet.
- IV. Konsolidimi i mekanizmave institucionalë, integritimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në politikën dhe qeverisjen vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbrëthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si

<sup>19</sup> Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: [https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte\\_egalite\\_al.pdf](https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf)

dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitutional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

PVVBGJ 2026–2030 mbështetet në një qasje transformuese gjinore, e cila synon jo vetëm fuqizimin e grave dhe vajzave, por edhe transformimin e normave shoqërore, roleve tradicionale gjinore dhe strukturave institucionale që riprodhojnë pabarazitë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.

Në këtë kuadër, plani promovon edhe përfshirjen aktive të burrave dhe djemve në parandalimin e dhunës me bazë gjinore, në ndarjen e përgjegjësisë familjare, në proceset vendimmarrëse dhe në ndërtimin e modeleve pozitive të maskulinitetit, duke synuar ndryshimin afatgjatë të marrëdhënieve gjinore në nivel komunitar dhe institucional.

Masat e targetuara për gratë dhe vajzat reflektojnë nevojën për të adresuar disavantazhet strukturore dhe pabarazitë historike, në përputhje me parimin e drejtësisë gjinore dhe me kuadrin kombëtar e ndërkombëtar për barazinë gjinore.

## **Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit**

### **Fusha e ndërhyrjes:**

#### **I. Fuqizimi ekonomik dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në tregun e punës dhe zhvillimin vendor**

#### **Rezultatet e pritshme:**

- I.a. Veprimet e bashkisë për rritjen e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në punësim dhe mundësi ekonomike, të përmirësuara dhe të orientuara drejt nevojave të tregut vendor.
- I.b. Masat e bashkisë për mbështetjen e integritit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në një treg pune të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të përmirësuara dhe të përshtatura me nevojat e tyre specifike, përfshirë përmes zhvillimit të shërbimeve të kujdesit dhe mbështetjes për balancën punë–familje.

#### **Objektivat specifikë:**

- I.1. Rritja e punësimit, aftësimin profesional dhe sipërmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në sektorët me potencial zhvillimi në Bashkinë Durrës.

- I.2. Fuqizimi ekonomik dhe social i grave fermere dhe grave e të rejave në të gjithë diversitetin e tyre, në zonat rurale, përmes rritjes së aksesit në burime financiare, njohuri, tregje dhe përfaqësim, me synim zhvillimin e një ekonomie bujqësore të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- I.3. Përmirësimi i kushteve për integrimin e grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre në tregun e punës, përmes forcimit të balancës punë–familje dhe zhvillimit të shërbimeve të ekonomisë së kujdesit

**Treguesit në nivel objektiv specifik:**

- I.1.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave që kanë përfunduar programe të formimit profesional dhe aftësimin, të ndara sipas llojit të trajnimit, moshës, aftësive, etnisë dhe vendbanimit.
- I.1.b. Numri i grave, të rejave dhe vajzave që janë punësuar ose përfshirë në aktivitete ekonomike (vetëpunësim, sipërmarrje) në kuadër të programeve dhe aktiviteteve të bashkisë, gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ).
- I.2.a. Numri dhe përqindja e grave fermere të regjistruara gjatë periudhës së zbatimit të këtij PVVBGJ.
- I.2.b. Përqindja e grave fermere përfituese nga skemat e subvencioneve dhe granteve
- I.3.a. Numri i shërbimeve të kujdesit (për fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara) të krijuara, të zgjeruara ose të përmirësuara nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të PVVBGJ.
- I.3.b. Numri i familjeve dhe grave të lehtësuara nga shërbimet e kujdesit dhe shërbimet sociale të mbështetura nga bashkia.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në jetën publike dhe vendimmarrjen në nivel vendor, në funksion të një qeverisjeje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.**

**Rezultatet e pritshme:**

- II.a. Veprimet e bashkisë për nxitjen e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në jetën publike dhe proceset vendimmarrëse, të përmirësuara dhe më të strukturuar.
- II.b. Masat për rritjen e përfaqësimit dhe përfshirjes aktive të grave, të rejave dhe vajzave në strukturat vendimmarrëse dhe proceset konsultuese në nivel vendor, të forcuara dhe të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

**Objektivat specifikë:**

- II.1. Rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në jetën publike dhe proceset vendimmarrëse në nivel vendor.

**Treguesit në nivel objektiv specifik:**

- II.1.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave të përfshira në aktivitete publike, procese konsultuese dhe struktura vendimmarrëse në nivel vendor, gjatë zbatimit të këtij PVVBGJ.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**III. Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe forcimi i sigurisë, reziliencës dhe menaxhimit gjithëpërfshirës së emergjencave në komunitet.**

**Rezultatet e pritshme:**

- III.a. Veprimet e bashkisë për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të përmirësuara dhe të shtrira në nivel komunitar.

III.b. Mekanizmat vendorë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të forcuara dhe më efektive.

**Objektivat specifikë:**

III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe shërbimeve për parandalimin, referimin trajtimin efektiv dhe riintegrimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

III.2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndryshimi i qëndrimeve në komunitet për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe promovimin e barazisë gjinore.

III.3. Forcimi i sigurisë, reziliencës komunitare dhe menaxhimit të emergjencave, përmes përfshirjes aktive të grave, të rejave dhe të rinjve, si dhe promovimit të Agjendave “Gruaja, Paqja dhe Siguria” dhe “Rinia, Paqja dhe Siguria”.

**Treguesit në nivel objektiv specifik:**

III.1.a. Numri i rasteve të trajtuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) në nivel vendor, në përputhje me standardet dhe legjislacionin e përmirësuar, gjatë periudhës së zbatimit të PVVBGJ

III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjëse të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

III.3.a. Numri i ndërhyrjeve infrastrukturore të bazuara në auditet e sigurisë, gjatë periudhës së zbatimit të këtij PVVBGJ

III.3.b. Numri i aktiviteteve mbi paqen dhe sigurinë të realizuara nga të rejt/rinjtë në bashkëpunim me KVSP.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**IV. Konsolidimi i mekanizmave institucionalë, integritit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në politikat dhe qeverisjen vendore.**

**Rezultatet e pritshme:**

IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparencja e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.

IV.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integriti gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë.

**Objektivat specifikë:**

IV.1. Forcimi i mekanizmave institucionalë dhe kapaciteteve të bashkisë për drejtimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të barazisë gjinore në nivel vendor.

**Treguesit në nivel objektiv specifik:**

IV.1.a. Numri i raporteve vjetore të monitorimit të zbatimit të PVVBGJ, të miratuara dhe të publikuara.

IV.1.b. Numri i programeve buxhetore të analizuara nën këndvështrimin gjinor.

## VII. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2026 - 2030

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2026 - 2030 do të shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj. – ***pra që nuk ka nevojë për kosto shtesë pasi këto kosto parashikohen në mënyrë të përvitshme.*** Megjithatë, në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2026 - 2030 do të evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përlllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VII “Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2030”, për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e kostos do të jepet informacion për:

- a. **Vlerën totale të kostos të zhvillimit të masës/aktivitetit.** Kjo kosto do të përlllogaritet si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimi i aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ.
- b. **Vlerën e kostos që mbulohet nga Bashkia.** Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë pune ia kushtojnë zbatimit të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit “në natyrë (in kind)” përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përlllogaritjet financiare.
- c. **Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët.** Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakortësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre. Në këtë rast, janë përlllogaritur si të mbuluara, vetëm kostot për ato aktivitete që ka pasur një dakortësi / marrëveshje mes bashkisë dhe donatorit, në momentin e përgatitjes së këtij PVVBGJ. Paralelisht, bashkia do vijojë punën për identifikimin e donatorëve të ndryshëm dhe shtimin e mbështetjes nga ana e tyre, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij PVVBGJ.
- d. **Hendeku financiar.** Ky ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negociimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2027 - 2029.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2030, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, **duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara**, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përlllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2026 - 2030 janë në vlerën **xxx lekë**. Nga këto:

- **xxx lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I “Fuqizimi ekonomik dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në tregun e punës dhe zhvillimin vendor”.
- **xxxx lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II “Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në jetën publike dhe vendimmarrjen në nivel vendor, në funksion të një qeverisjeje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë”.
- **xxx lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III “Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe forcimi i sigurisë, reziliencës dhe menaxhimit gjithëpërfshirës së emergjencave në komunitet”.
- **xxxx lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV “Konsolidimi i mekanizmave institucionalë, integritimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në politikat dhe qeverisjen vendore.”

Në totalin e kostos **xxxx lekë** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2026-2030 për të gjithë kohëzgjatjen e tij:

- **xxxxx lekë janë kosto që do të mbulojnë nga Bashkia** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra **të cilat nuk kanë nevojë të përlllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukurore ekzistojnë**.
- **xxxxx lekë janë kosto që mbulojnë nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakortësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PVVBGJ-së).
- **xxxx lekë janë hendek financiar**, për të cilat bashkia do të llojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në PBA-të e ardhshme, duke filluar nga PBA 2027 – 2029.

## VII. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

**Procesi i raportimit** për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek **Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel të Bashkisë**, ngritur me Urdhër të Kryetares nr.126, datë 08.04.2026, me përfaqësuese dhe përfaqësues nga secila Drejtori në Bashki, me detyra të përcaktuara qartësisht, përfshirë dhe në pjesën e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të PVVBGJ-së.

Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2030, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen gjithashtu edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mbledhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike.

**Raportimet mbi aktivitetet do të jenë periodike (çdo 3 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore / Grupit të Monitorimit në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetares/Kryetarit.

**Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten **dy herë në vit (çdo 6 muaj)**.

**Monitorimi** i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak. Bashkia ka përgjegjësinë të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak një raport monitorimi çdo vit.**

Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale (MSHMS), te Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor apo edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ **duhet të rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike, sipas nevojës, qoftë edhe **çdo një vit** nga data e fillimit të zbatimit të tij.

## VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026 – 2030

<b>Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik):</b>	<b>I. FUQIZIMI EKONOMIK DHE RITJIA E PJESËMARRJES SË GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE, NË TREGUN E PUNËS DHE ZHVILLIMIN VENDOR</b>			
<b>Rezultatet e pritshme:</b>	<p>I.a. Veprimet e bashkisë për rritjen e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në punësim dhe mundësi ekonomike, të përmirësuara dhe të orientuara drejt nevojave të tregut vendor.</p> <p>I.b. Masat e bashkisë për mbështetjen e integritit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në një treg pune të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të përmirësuara dhe të përshtatura me nevojat e tyre specifike, përfshirë përmes zhvillimit të shërbimeve të kujdesit dhe mbështetjes për balancën punë–familje.</p>			
<b>Dokumentet kryesore që u referohemi:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore – fushat që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor, punësimin dhe shërbimet publike, përfshirë shërbimet e kujdesit.</li> <li>- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 11, 12, 13.</li> <li>- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 6 (Gratë dhe ekonomia).</li> <li>- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – neni 12 paragrafi 6.</li> <li>- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, me fokus në fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen në tregun e punës.</li> <li>- Strategjia e Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore 2026–2030 – me fokus në fuqizimin ekonomik të grave, eliminimin e pabarazive në tregun e punës dhe promovimin e një ekonomie kujdesi të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.</li> <li>- Konventa nr. 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për dhunën dhe ngacmimin në botën e punës.</li> <li>- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivat për fuqizimin ekonomik dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.</li> </ul>			
<b>Objektivi specifik:</b>	<b>I.1. Rritja e punësimit, aftësimin profesional dhe sipërmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në sektorët me potencial zhvillimi në Bashkinë Durrës.</b>			
	<b>Treguesit:</b>	<b>Baseline: (2026)</b>	<b>Target: (2030)</b>	<b>MONITORIMI</b>
	I.1.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave që kanë përfunduar programe të formimit profesional dhe aftësimin, të ndara sipas llojit të trajnimit, moshës, aftësive, etnisë dhe vendbanimit.	Do përcaktohet gjatë vitit 2026	Rritur me 10% mbi vlerën bazë	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie;
	I.1.b. Numri i grave, të rejave dhe vajzave që janë punësuar ose përfshirë në aktivitete ekonomike (vetëpunësim, sipërmarrje) në kuadër të programeve dhe aktiviteteve të bashkisë, gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ).	Do përcaktohet gjatë vitit 2026	Rritur me 5% mbi vlerën bazë	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak.

MASAT DHE AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	TREGUES	KOSTO (LEKË)				
	Përgjegjës kryesor	Mbështetës			2026	2027	2028	2029	2030
I.1.1. Marrëveshje bashkëpunimi me AKPA dhe referimi aktiv i grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, drejt programeve të punësimit dhe trajnimit, të përshtatura me kërkesat e reja të tregut të punës	Drejtoria e Shërbimit Social	AKPA, QFP, Drejtoria Ligjore, OJF	2026 - 2030	Marrëveshja e nënshkruar, me fokus programet e trajnimeve të orientuara nga kërkesat e tregut në Durrës; 90 referime të përvitshme, ndarë sipas moshës, llojit të programit ku referohet, vendbanimit, aftësive, etnisë, etj.	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet
I.1.2. Mbështetja për start-up <sup>20</sup> dhe vetëpunësim, për gratë, të reja dhe të rinjtë, në të gjithë diversitetin e tyre	Drejtoria e Turizmit; Drejtoria e Shërbimit Social	Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit, OJF, SHGPS	2026 - 2030	Fondi për start up në vlerën 400,000 lekë në vit, i përcaktuar në buxhetin e bashkisë 15 persona të mbështetur cdo	400,000 lekë (bashkia)	400,000 lekë (bashkia)	400,000 lekë (bashkia)	400,000 lekë (bashkia)	400,000 lekë (bashkia)

20 Shoqata "Gender, Paqe e Siguri" ka pasur dhe vijon të ketë në fokus të punës së saj fuqizimin ekonomik të grave. Përgjatë vitit 2026 ka të parashikuar në buxhetin e saj mbështetjen me kurse profesionale, materiale pune dhe start-up për të paktën 20 gra, viktimë të dhunës dhe pjesë të grupeve të marginalizuara.

<p>I.1.3. Takime me të reja dhe të rinj NEET të moshës 15-29 vjeç, për t'i informuar dhe nxitur të përfshihen në Programin e Garancisë Rinore, si programi më inovativ për të rejtat/rinjtë, që u ofron mundësi punësimi, arsimimi e formimi profesional.</p>	<p>Drejtoria e Arsim -Kulturë-Sport-Rini-Komunitete Fetare</p>	<p>AKPA, QFP, Drejtoria e Shërbimit Social, shkollat, NJA, OJF, World Vision</p>	<p>2026 - 2030</p>	<p>vit, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, aftësive, llojit të sipërmarrjeve, etj. 6 takime cdo vit 15 persona të informuar, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, aftësive, vendbanimit, etj.</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>
<p>I.1.4. Organizimi i panairove të punës dhe eventeve<sup>21</sup> për promovimin e sipërmarrjes së grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre</p>	<p>Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile</p>	<p>AKPA, Drejtoria Ekonomike, OJF, SHGPS</p>	<p>2026 - 2030</p>	<p>Numri i panairove të organizuara cdo vit; Numri i grave dhe të rejave pjesëmarrëse, ndarë sipas moshës, etnisë, aftësive, vendbanimit,</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>	<p>Do përlllogaritet</p>

<sup>21</sup> SHGPS për vitin 2026 ka planifikuar 2 takime në muaj (24 takime në vit) me një ekspert/e të fuqizimit ekonomik, si dhe cdo 3 muaj (4 takime në vit) ka planifikuar takime me gra mentore biznesemene, të cilat i orientojnë gratë dhe vajzat drejt botës së biznesit.

I.1.5. Krijimi i lehtësirave (si vend i caktuar, apo dyqan ku qeranë e mbulon bashkia), për shitjen e produkteve artizanale dhe të prodhuara nga gratë e grupeve të cenueshme (kryesisht viktima të dhunës apo nëna kryefamiljare nga familje në vështirësi ekonomike), për një periudhë të caktuar kohore.	Drejtoria e Turizmit	Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile, OJF, SHGPS	2027 - 2030	llojit të produkteve, etj. Lista e kriterëve për të përcaktuar përfitueset nga kjo iniciativë dhe periudha kohore, e përgatitur dhe miratuar në Këshillin Bashkiak; Vendi për shitjen e produkteve të prodhuara nga gratë, i përcaktuar dhe funksional. Të dhënat mbi gratë përfituese, ndarë sipas, moshës, etnisë, vendbanimit, dhe kriterëve të përcaktuara për të përfituar nga kjo lehtësi, të mbajtura rregullisht dhe	N/a	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet
---	----------------------	--	-------------	--	-----	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------

I.1.6. Trajnime dhe mentorim <sup>22</sup> për gratë,të rejat dhe të rinjtë, në të gjithë diversitetin e tyre, për rritjen e aftësive digjitale dhe përdorimin praktik të teknologjisë në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe profesionale	Drejtoria e Arsim -Kulturë-Sport-Rini-Komunitete Fetare, Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Drejtoria e Turizmit	AKPA, QFP, Drejtoria Ekonomike, Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Durrës, OJF, bizneset e zonës	2026 – 2030	në mënrë të përditësuar. 4 trajnime të planifikuara për vitin 2026 dhe nga 2 trajnime cdo vit për vitet 2027-2030; 15 persona të përfshirë në cdo takim, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, aftësive, vendbanimit, llojit të produkteve, etj.	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet
I.1.7. Krijimi i skemave të mbështetjes së bizneseve sociale dhe zbatimi i tyre sipas kriterëve që do përcaktohen dhe legjislacionit në fuqi	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ligjore	Drejtoria Ekonomike , OJF	2026 - 2030	Skema e mbështetje së bizneseve sociale e krijuar; Numri i bizneseve sociale të mbështetura pas vënies në funksionim të kësaj skeme	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet

<sup>22</sup> Një pjesë e këtyre trajnimeve dhe sesioneve mentoruese do planifikohen në marrëveshjen e bashkëpunimit që do lidhet me AKPA, sic është planifikuar në aktivitetin I.1.1. më sipër

I.1.8. Trajnimi i punonjëseve/punonjësve të administratës së Bashkisë Durrës, mbi Konventën C190 të ONP-së dhe ngacmimet seksuale në vendin e punës	Të gjitha drejtoritë <sup>23</sup>	Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Drejtoria e Shërbimit Social; Drejtoria Ligjore, ASPA OJF	2027 - 2030	2 trajnime të zhvilluara cdo vit 20 persona të përfshirë në cdo trajnim, ndarë sipas seksit, moshës, pozitës në bashki, etj.	N/a	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet
I.1.8. Përfshirja në Kodin Etik të bashkisë e masave në lidhje me raportimin dhe zgjidhjen e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës (në përputhje edhe me masat në Konventën C190 të ONP-së)	Drejtoria e Burimeve Njerëzore <sup>24</sup>	Drejtoria Ligjore; Drejtoria e Shërbimit Social	2026 - 2027	Masat mbi mënyrën dhe strukturat në bashki ku bëhet denoncimi dhe trajtimi për rastet e ngacmimit seksual në vendin e punës, të përfshira në Kodin Etik dhe të njohura për të gjitha/gjithë.	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	N/a	N/a	N/a

<b>Objektivi specifik:</b>	<b>I.2. Fuqizimi ekonomik dhe social i grave fermere dhe grave e të rejave në të gjithë diversitetin tyre, në zonat rurale, përmes rritjes së aksesit në burime financiare, njohuri, tregje dhe përfaqësim, me synim zhvillimin e një ekonomie bujqësore të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.</b>								
	<b>Treguesit:</b>			<b>Baseline:</b>	<b>Target:</b>	<b>MONITORIMI</b>			
				<b>(2026)</b>	<b>(2030)</b>				

<sup>23</sup> Kërkesat përcillen nga secila drejtori në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në bazë të formularit përkatës që plotësohet nga secila/secili punonjëse/punonjës në bashki, në lidhje me kërkesat për trajnime dhe aftësim profesional. Më pas DBNJ i përcjell këto kërkesa të ASPA.

<sup>24</sup> Kodi i Etikës është në process rishikimi. Pasi të përcillen të gjitha komentet dhe sugjerimet pranë DBNJ, Drejtoria Ligjore do të pasqyrojë në këtë Kod masat në lidhje me raportimin dhe zgjidhjen e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës në përputhje edhe me Konventën C190 të ONP-së

I.2.a. Numri dhe përqindja e grave fermere të regjistruara gjatë periudhës së zbatimit të këtij PVVBGJ.					Do përcaktohet gjatë vitit 2026	Rritur me 10% nga vlera bazë	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie;  Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit , si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak.		
I.2.b. Përqindja e grave fermere përfituese nga skemat e subvencioneve dhe granteve					Do përcaktohet gjatë vitit 2026	Rritur me 5% nga vlera bazë	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit , si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak.		
MASAT DHE AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	TREGUES	KOSTO (LEKË)				
	Përgjegjës kryesor	Mbështetës			2026	2027	2028	2029	2030
I.2.1. Informim i grave dhe burrave në NJA mbi skemat bujqësore dhe mundësitë e tregut	Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, Drejtoria e Shërbimit Social, OJF	2026 - 2030	Numri i takimeve informuese të zhvilluara cdo vit; Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj.	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet
I.2.2. Organizimi i trajnimeve profesionale për gratë dhe burrat, në teknika moderne bujqësore, menaxhim ferme dhe marketing.	Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, AZHBR, OJF	2026 - 2030	Numri i trajnimeve profesionale të zhvilluara në vit; Numri i personave të përfshirë, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të trajnimit, etj.	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet
I.2.3. Nxitja e regjistrimit të grave si fermere të pavarura	Drejtoria e Zhvillimit Rural,	NJA	2026 - 2030	Numri i takimeve për nxitjen e	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet	Do përllogaritet

	Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile			regjistrimit të grave si fermere; Numri i grave të regjistruara si fermere cdo vit					
I.2.4. Shkëmbim eksperience, themelimi dhe mbështetja e grupeve të organizuara të grave fermere, të rregjistruara dhe të përshtatura për të përfituar lehtësirat sipas legjislacionit në fuqi	Drejtorja e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, Drejtorja Ekonomike, Drejtorja Ligjore, Institucioni i Prefektit	2027 - 2030	Numri i vizitave/takimeve për shkëmbim eksperience; Grupimi formal i grave fermere i themeluar, regjistruar dhe mbështetur në mënyrë të vazhdueshme	N/a	Do përlogaritët	Do përlogaritet	Do përlogaritët	Do përlogaritët
I.2.5. Mbështetje për fermeret dhe fermerët në të gjithë diversitetin e tyre, për përpunim, paketim dhe markim produktesh	Drejtorja e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, Drejtorja Ekonomike, Drejtorja e Turizmit, OJF	2027 - 2030	Numri i fermerëve dhe fermerëve të mbështetur për përpunimin, paketimin apo markimin e produkteve, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të produktit, etj	N/a	Do përlogaritët	Do përlogaritet	Do përlogaritët	Do përlogaritët
I.2.6. Krijimi i mundësive për promovimin dhe tregtimin e produkteve	Drejtorja e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, Drejtorja Ekonomike, Drejtorja e Turizmit	2026 - 2030	Numri i tregjeve, apo panairove të produkteve bujqësore të organizuara;	Do përlogaritet	Do përlogaritët	Do përlogaritet	Do përlogaritët	Do përlogaritët

të grave (panaire, tregje lokale). <sup>25</sup>				Numri i grave pjesëmarrëse, ndarë sipas moshës, vendbanimit, llojit të produktit, etj.					
I.2.7. Lehtësimi i aksesit të grave në kredi dhe financim për agrobiznes	Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, Drejtoria Ekonomike, Institucioni i Prefektit	2027 - 2030	Numri i takimeve dhe marrëveshjeve me institucione financiare që ofrojnë lehtësi për financim në agrobiznes për gratë; Numri i grave të informuara/ trajnuara për akses në financë	N/a	Do përlogaritët	Do përlogaritet	Do përlogaritët	Do përlogaritët
I.2.8. Hartimi dhe zbatimi i skemave të subvencioneve për gra fermere	Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile	NJA, Drejtoria Ekonomike, Institucioni i Prefektit	2027 - 2030	Numri i skemave të subvencioneve të miratuara në Bashki (Këshill Bashkiak); Numri i grave që përfitojnë nga këto grante apo subvencione	N/a	Do përlogaritët	Do përlogaritet	Do përlogaritët	Do përlogaritët

**Objektivi specifik:** I.3. Përmirësimi i kushteve për integrimin e grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre në tregun e punës, përmes forcimit të balancës punë–familje dhe zhvillimit të shërbimeve të ekonomisë së kujdesit

**Treguesit:**

**Baseline:  
(2026)**

**Target:  
(2030)**

**MONITORIMI**

<sup>25</sup> Ky aktivitet është në vijim (dhe nuk mbivendoset) me aktivitetin I.1.4. më sipër

I.3.a. Numri i shërbimeve të kujdesit (për fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara) të krijuara, të zgjeruara ose të përmirësuara nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të PVVBGJ.

Do përcaktohet gjatë vitit 2026

Rritur me 5% mbi vlerën bazë

Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie;

I.3.b. Numri i familjeve dhe grave të lehtësuara nga shërbimet e kujdesit dhe shërbimet sociale të mbështetura nga bashkia.

25 gra të 25 familjeve lehtësohen aktualisht nga ngarkesa e kujdesit, përmes shërbimeve të kujdesit dhe shërbimeve sociale të bashkisë

Rritur me 20% mbi vlerën bazë

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak.

MASAT DHE AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	TREGUES	KOSTO (LEKË)				
	Përgjegjës kryesor	Mbështetës			2026	2027	2028	2029	2030
I.3.1. Vlerësimi i situatës dhe nevojave në lidhje me shërbimet e kujdesit për fëmijët vajza dhe djem në Durrës	Drejtorja e Arsim -Kulturë-Sport-Rini-Komunitete Fetare	Drejtorja e Shërbimit Social	2026 - 2027	Raporti i vlerësimit me të dhënat dhe rekomandiet përkatëse i përgatitur	Do përlogarit	Do përlogaritet	N/a	N/a	N/a
I.3.2. Planifikimi i ngritjes së qendrave të reja komunitare në zonat ku mungojnë dhe sipas nevojës, bazuar në rezultatet e vlerësimit që po realizohet sipas I.3.1 më sipër	Drejtorja e Shërbimit Social	Drejtorja e Buxhetit	2028 - 2030	Nevojat për ngritjen e shërbimeve dhe zonat përkatëse të evidentuara; Planifikimi dhe ngritja e tyre e përfshirë në	N/a	N/a	Sipas vlerësimit të nevojave dhe studimit të fizibilitetit	Sipas vlerësimit të nevojave dhe studimit të fizibilitetit	Sipas vlerësimit të nevojave dhe studimit të fizibilitetit

I.3.3. Ngritja e shërbimeve të kujdesit për fëmijët (cerdhe, kopshte) në zonat me kërkesa të larta	Drejtoria e Arsim -Kulturë-Sport-Rini-Komunitete Fetare	Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Buxhetit	2028 - 2030	buxhetin e bashkisë Të paktën 2 shërbime të ngritura (1 cerdhe dhe 1 kopësht), bazuar edhe në vlerësimin që do realizohet sipas I.31 më sipër, si dhënë përputhje me parashikimet në Planin Social 2025-2028.	N/a	N /a	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet	Do përlllogaritet
